

VENDIM
Nr. 49, datë 29.1.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në listën e shkronjës “C”, të titulluar: “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën *ISIL (Da’esh)* dhe *Al-Qaida*”, hiqet individi i renditur në shkronjën “a”, sipas ndryshimit bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës *ISIL (Da’esh)* dhe *Al-Qaida*.

2. Në listën e shkronjës “D”, të titulluar: “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën *ISIL (Da’esh)* dhe *Al-Qaida*”, hiqen entitetet e renditura në shkronjën “d”, sipas ndryshimit bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës *ISIL (Da’esh)* dhe *Al-Qaida*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-së
(“LISTA E OKB-së”)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT *ISIL (DA’ESH)* dhe *AL-QAIDA*

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat *ISIL (Da’esh)* dhe *Al-Qaida*”;

1. MOURAD 2. BEN ALI 3. BEN AL-BASHEER 4. AL-TRABELSI

D. LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË ME ORGANIZATËN *ISIL (DA’ESH)* DHE *AL-QAIDA*

d) Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën *ISIL (Da’esh)* dhe *Al-Qaida*

STATE ORGANIZATION FOR IRRIGATION PROJECTS GENERAL ESTABLISHMENT FOR IRRIGATION PROJECTS

STATE ORGANIZATION FOR LAND RECLAMATION

GENERAL ESTABLISHMENT FOR PLANTATION AND DEVELOPMENT OF THE RECLAIMED LANDS b) GENERAL ESTABLISHMENT FOR EXECUTION OF LAND

RECLAMATION CONTRACTS c) GENERAL ESTABLISHMENT FOR LAND RECLAMATION OF CENTRAL AND NORTHERN AREAS d) GENERAL ESTABLISHMENT FOR LAND RECLAMATION OF SOUTHERN AREAS

Shënim: Gjenealitetet e tjera për personat dhe kompanitë, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.